Gjenden armë dhe mjete eksploduese gjatë bastisjeve në veri

13:31
Gjenden armë dhe mjete eksploduese gjatë bastisjeve në veri
10:30
Bastisje në veri lidhur me sulmin në Banjskë

13:31

Gjenden armë dhe mjete eksploduese gjatë bastisjeve në veri

14 tetor 2023, 10:30

Policia e Kosovës ka konfirmuar se ka gjetur armë, mjete eksploduese dhe pajisje të tjera ushtarake gjatë bastisjeve të kryera të shtunën në veri.

Zëvendësdrejtori i Policisë së Kosovës për rajonin e veriut, Veton Elshani, ka thënë për KOHËN se bastisjet janë kryer në shtatë lokacione të ndryshme në veri.

Në një podrum, në vendin e njohur si "Tre Rrokasejet" në Mitrovicë të Veriut, janë gjetur armët, mjetet eksploduese dhe pajisjet e tjera, sipas Elshanit.

"Bastisjet janë kryer në katër lokacione në Mitrovicë të Veriut, dy në Zveçan dhe një në Banjskë", ka thënë ai.

Gjatë bastisjeve në Mitrovicën e Veriut ishte i pranishëm edhe KFOR-i e EULEX-i.

Policia e Kosovës, që pas sulmit në Banjskë të Zveçanit më 24 shtator ku u vra mesheri Afrim Bunjaku, ka kryer disa bastisje që lidhen me sulmin terrorist.

Lista preliminare e armëve dhe pajisjeve tjera të sekuestruara:

- 87 copë eksplozivi të tipit TM 100
- 3 granata hedhës dore (zola)
- 1 armë automatike AK-47
- 1 miinë kundër këmbësorisë e tipit MRUD
- 14 karikatorë
- Municion të kalibrave të ndryshëm
- 63 detonatorë elektrik
- 23 detonatorë mekanik
- 1 orë për aktivizim
- 1 granatë dore M79
- 3 tuba frilla ndezës
- Çanta, radiolidhje, antipllumba, pajisje medicinale, gykonë (pllekë për bartje të karikatorëve), maskë kundër gazit, bateri etj.

10:30

Bastisje në veri lidhur me sulmin në Banjskë

Policia është duke bastisur disa lokacione në veri të vendit lidhur me sulmin e 24 shtatorit në Banjskë.

Nga PK-ja është thënë se janë duke zhvilluar operacionin, ndërsa nuk dihet ende nëse ka ndonjë të arrestuar deri tash.

Më 24 shtator, si pasojë e një sulmi të armatosur në Banjskë të Zveçanit u vra polici Afrim Bunjaku. Në aksionin e Policisë, dhjetëra sulmues të armatosur e uniformuar serbë u rrethuan në fshatin Banjskë. Policia u sulmua në vazhdimësi nga sulmuesit. Nga aksioni tre sulmues u vranë. Është kapur edhe arsenal i madh armësh.

Përgjegjësinë për organizimin e grupit të armatosur e pati marrë Milan Radoiçiq, ish-nëkryetar i Listës Serbe, partisë më të madhe të serbëve të Kosovës. Ai u lirua nga Gjykata e Lartë e Serbisë, një ditë pasi u ndalua nën dyshimet se ka kryer një sërë veprash - përfshirë trafikim armësh dhe krime kundër sigurisë së përgjithshme. Gjykata ia ndaloi daljen nga Serbia dhe e obligoi të paraqitet në stacionin kompetent policor dy herë në muaj.

Sipas Prokurorisë serbe, Radoiçiq dyshohet se "ka siguruar armë, municione dhe mjete shpërthyese me fuqi të madhe shkatërruese nga Tuzla, në Federatën e Bosnje-dhe Hercegovinës, nga janari 2023 deri më 24 shtator". Më pas, ato armë "ai i ka transportuar dhe ruajtur në vende të pacaktuara në territorin e Kosovës, ku i ka fshehur në objekte të braktisura dhe pyje", sipas Prokurorisë serbe.

Radoiçiq i mohoi këto vepra.

Pozita strategjike e Banjskës u dha zemër terroristëve për sulm ndaj...
Pas tri dëshës bllokadë, fshati Banjskë...
koha.net

Arsenali i armëve që u gjet në Banjskë, në 70 fotografi
Armatim i rëndë, automjete e pajisje t...
koha.net

© KOHA. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalin tonë zyrtar në Viber

Taboola Feed

Radio e Jashtme e Kinës
CRI ofron shërbime të pasura audiovizive për audiencën në mbarë botën
CRI | Sponsored

8 Real Animals That Shouldn't Exist, But Do Anyway
LuvsMyFamilyBlog.com | Sponsored



Call Center Jobs: The Benefits Might Surprise You.
Your future starts here: Call center jobs.
Call Center Jobs | Search Ads | Sponsored
Search Now



Arsimi në distancë pavarësisht moshës. Shikoni listën
Studimi në distancë | Search Ads | Sponsored



After Losing 60lbs Lizzo Is Unbelievably Gorgeous!
Game of Glam | Sponsored
Read More

This is What Will Happen When You Eat Kale Every Day
Food World Blog.com | Sponsored

Në lokalin ku u helmuan mëth 100 persona u gjetën produkte pa origjinë

Vitia flet për gjendjen e pacientëve që u helmuan në Malishevë

KFOR-i përforcohet edhe me 130 trupa nga Rumania

Moti sot në Kosovë

Mujanoviq për Asociacionin: Përzierja e territorit me etninë, recetë për luftë

Kosova akuzon Serbinë se ka shkelur marrëveshjen me SHBA-në për mjetet ushtarake

Prishet koalicioni udhëheqës në Parlamentin Studentor

Kurti numëron "sukseset" e bashkëpunimit Kosovë – Shqipëri

Listë e gjatë e pritjes në Ortopedi, drejtori ankohen për mungesë të investimeve

Alarmohet se veriu i Kosovës është vatër me e rrezikshme se Bosnja

Së shpejti në KTV: "E njohura e panjohur" me Arianit Kocin

Osmani shpreh mirënjohje për përforcimin e trupave të KFOR-it

TË FUNDIT

Në lokalin ku u helmuan mëth 100 persona u gjetën produkte pa origjinë

Vitia flet për gjendjen e pacientëve që u helmuan në Malishevë

KFOR-i përforcohet edhe me 130 trupa nga Rumania

Moti sot në Kosovë

Mujanoviq për Asociacionin: Përzierja e territorit me etninë, recetë për luftë

Kosova akuzon Serbinë se ka shkelur marrëveshjen me SHBA-në për mjetet ushtarake

Prishet koalicioni udhëheqës në Parlamentin Studentor

Kurti numëron "sukseset" e bashkëpunimit Kosovë – Shqipëri

Listë e gjatë e pritjes në Ortopedi, drejtori ankohen për mungesë të investimeve

Alarmohet se veriu i Kosovës është vatër me e rrezikshme se Bosnja

Së shpejti në KTV: "E njohura e panjohur" me Arianit Kocin

Osmani shpreh mirënjohje për përforcimin e trupave të KFOR-it

BALLINA LAJME ZGJEDHJET 2021 KRONIKË KULTURË MES PËR MES VËSHTRIME SPORT HOROSKOPI PODCAST VIDEO MREKULLIA

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në to, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i pavarësisë qoftë origjinal apo i modifikuar në çfardo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe internet a medium tjetër pa leqen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësive që e përbëjnë (Koha Ditore, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjitha shkeljet e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.
Rëfiktiimi i përmbajtjeve në gjuhët tjera bëhet në mënyrë automatike dhe mund të kenë gabime!